


***Shenime mbi pasqyrat financiare***

**“Ng Structures”shpk  
(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)**

**29 Prill 2020**



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Ng Structures”shpk**  
**(Per ushtrimin e myllur me date 31.12.2019)**

---

### **1. Informacion i përgjithshëm.**

Shoqëria “Ng Structures” shpk është date 24.07.2017, regjistruar në Drejtorene Rajonale Tatimore Gjirokaster, me nipt L79326502O.

Veprimtaria e shoqërise rregullohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare” i ndryshuar, nga statuti dhe Legjislacioni ne fuqi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërise “Ng Structures” shpk është: Shoqëri Ndërtimi/Zbatimi dhe Studim-Projektimi e Konsulencës, përbledhur në: Punime gërmimi në tokë; Ndërtimë civile dhe industriale; Rikonstruksione dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash; Rrugë autostrada mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale; Punime nëntokësore, ura e vepra arti; Diga dhe tunele hidroteknike; Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vadirje; Ndërtimë detare dhe punime thellimi në ujë; Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime; Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike; Ndërtimë për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë; Punime të inxhinierisë së mjedisit; Punime për prishjen e ndërtimeve; Impianti hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre; Impianti ngritëse dhe 2 transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues); Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese; Impianti të sinjalistikës ndriçuese të trafikut; Sinjalistika rrugore jondriçuese; Bariera dhe mbrojtje rrugore; Ndërtimë parafabrikat beton/arre, struktura metalike dhe drur; Punime strukturore speciale; Shtresa dhe mbistruktura speciale; Punime mbi shina dhe traversa; Impianti teknologjik, termike dhe të kondicionimit; Impianti dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni; Impianti të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.; Pastrimi i ujërave detare, ligenore dhe lumore; Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij; Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane; Punime topogjeodezike; Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë; Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë. Mirëmbajtje objektesh. Studim-Projektime në: Plane kombëtare sektoriale; Plane të detajuara për zona të rëndësishë kombëtare; Plane sektoriale në nivel qarku; Plane sektoriale në nivel bashkie; Plane të detajuara vendore. Projektim arkitekturor. Projektim interiore; Projektim peizazhi, sistemim sipërsaqe të gjelbra, lulishte e parqe. Objekte civile, industrial, turistike. Objekte me shkallë të lartë vështirësie; troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët. Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike. Objekte civile e turistike prej druri. Projektim të instalimeve hidro-termosanitare. Instalime termoteknikë; kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme. Linjat e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale. Sistemeve komplekse të telekomunikacionit. Sisteme të furnizimit me gaz. Sistemeve kundra zjarrit. Sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa. Impianti ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.). Ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj. Rrjete të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj. Diga. Furnizim me ujë, kolektore shkarkimi. Ujësjellës-kanalizime urbane, rurale. Vepra ujite; kullimi; 3 impiante



### **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**"Ng Structures"shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)**

vaditëse; diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha), damba, sifona, kaskada, kapërderdhës, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino. Vepra të trajtimit të ujit. Vepra hidroteknicë, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi; shkarkues të ujërave të tepërtë, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse. Vepra naftësjellës; gazzsjellës; vajsjellës etj. Vepra hidroteknicë; kulla ekuilibri, porte; pontile. Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore. Rrugë. Autostrada. Aeroporte; helioporte; hidroporte. Hekurudha; degëzime hekurudhore. Ura/viadukte, vepra arti dhe sisteme të tjera speciale. Tunele rrugore; hekurudhore. Rivelime inxhinierike. Rilevime inxhinierike kadastrale. Sisteme GIS. Bazamente gjëodezike. Fotogrametri dhe hartografi. Studim/vlerësim gjëologo-inxhinierik i truallit për objekte civile; ekonomike. Studim/vlerësim gjëologo-inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/C, porte aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha. Studim/vlerësim gjëologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët. Centrale hidraulike, termike. Impiantë të prodhimit të energjisë elektrike të rrinovueshme, diellore, ere etj. Nënstacione elektrike; linja të tensionit. Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës; Sinjalistikë jondriçuese në rrugë, sheshe e parkime, autostrada, rrugë, hekurudha në degëzime, në aeroporte dhe helioporte. Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë. Studime të rrezikut sizmik në cdo nivel. Studime e projekteve të ndërtimit dhe mbylljes së venddepozitiveve të mbetjeve të ngurta. Studime e projekteve të ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza. - Shërbime Konsulencë Teknike, Ligjore e Financiare. Të tjera si: Vlerësime: Mjedisore dhe Pasurive të paluajtshme; Restaurime në zbatim dhe projektim. -Ekspertizë teknike dhe teknologjike; Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. -Shit-blerje, import-eksportin e: Materiale ndërtimi, Linjave makinerive dhe pajisjeve teknologjike bujqësore, blektorisë, agroperpunimit, asete fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit, Sisteme frigoriferike, ventiliimi etj dhe montim. -Auditime energetike. Etj..

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është z. Hekuran Hoxha. Selia e Shoqerisë është në Lagjja "Selam Musai", Rruga Dule Dalani, Nr. pasurie 14/324, Zona Kadastrale 3574, Kati i dyte, Tepelene.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

## 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.


## 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### 2.3. Biznesi nē vijiměsi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

#### 2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Ng Structures”shpk**  
**(Per ushtrimin e myllur me date 31.12.2019)**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Leke, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.5. Vlerësimet dhe gjykime**

Paraqitura e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësimet dhe supozimet që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financier, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjera duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

#### **2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimet bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.


#### **2.5.2. Provizonet**

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të niveilit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

#### **2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Sic paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvetës rasteve kur riparaqitura e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

### **1. Politikat Kontabël**



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Ng Structures”shpk**  
**(Per ushtrimin e myllur me date 31.12.2019)**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### **1.1 Transaksionet në monedhë të huaj.**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82


### **1.2 Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë nijhen fillimi si me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi i që lidhet me to, përvèç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument finanziar nijhet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

- Mjetet monetare**

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme**



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Ng Structures”shpk**  
**(Per ushtrimin e myllur me date 31.12.2019)**

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferençë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbe nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare


Një aktiv finansiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finansiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

1.3 Inventarët



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Ng Structures”shpk**  
**(Per ushtrimin e myllur me date 31.12.2019)**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

### **1.4 Aktive afatgjata materiale**

#### **i. Njohja dhe matja**

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **ii. Kostot e mëpasshme**

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### **iii. Amortizimi**

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Paj, zyre e informat	Vlera e mbetur	20%

#### **iv. Cregjistrimi**



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**"Ng Structures"shpk**

**(Per ushtrimin e myllur me date 31.12.2019)**

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitme ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

### **3.5 Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitme ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitme mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

### **3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përvëç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

### **3.7 Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

### **3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.


Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### **3.9 Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përvëç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabel të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 eshte 15% (2018: 15%).



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Ng Structures”shpk**  
**(Per ushtrimin e myllur me date 31.12.2019)**

Tatim fitimi i shtyre përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijoen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyre njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferençat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferençat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

### **3.10 Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përsitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligor të vendosur për pensionet në juridikcionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

### **3.11 Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

### **3.12 Provisionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provisionet përcaktohen duke skontuar fluksit e pritsime të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provisionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provisionet rimerren.

### **3.13 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përsitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përsitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Ng Structures”shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)**

---

### **AKTIVET AFATSHKURTRA**

**Aktive monetare** për 1.610 lekë, perfaqesojne mjete monetare ne banke.

Shoqeria operon me disa banka, te gjitha veprimet jane rregistruar ne ditaret perkates, me llogarite ne valute veprimet jane kryer me kursin ditor te bankes, ndersa gjendja e monedhave te huaja ne fund te ushtrimit eshte vleresuar me kursin e Bankes se Shqiperise me date 31.12.2019 duke kaluar sipas rastit ne llogarite e shpenzimeve apo te ardhurave diferenca e kembimit.

Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit në vlerën 47.072.500 leke perfaqeson llogarine Kliente per vleren e faturave te paarketuara. Kjo llogari eshte e analizuar sipas klienteve dhe rakordon me llogarine sintetike te tyre.

**Te tjera te drejta te arketueshme ne shumen 3.119.647 leke paraqesin:**

- **Tvsh ne shumen 112.069 leke.**
- **Te tjera ne shumen 3.007.578 leke, detyrim te te treteve ndaj shoqerise.**

Ne llogarite Inventariale shoqeria ka paraqitur gjendjen e lendeve te para dhe materialeve te konsumueshme ne shumen 20.603.218 leke. Vleresimi i tyre ne fund te ushtrimit eshte bere me kosto faktike.

**Parapagime per inventar ne shumen 57.000 leke.**

### **Aktivet afatgjata materiale**

Shoqeria ka një vlerë neto aktivesh afatgjata materiale ne shumen 1.889.147 lekë e cila perfaqeson vleren e mbetur te pajisjeve te zyres dhe informatike. Aam jane shtuar gjate vitit 2019 ne shumen 665.417 leke dhe jane pakesuar per amortizimin e llogaritur ne shumen 305.900 leke.

### **DETYRIMET DHE KAPITALI**

**Kapitalet e veta paraqiten me vlerë 10.598.478 leke.**

**Kapitali i rregistruar i shoqërisë është 100.000 lekë, i perbere nga një kuote e cila i perket ortakut te vetem te shoqerise z. Hekuran Hoxha.**


**Rezerva ligjore ne shumen 30.329 leke e pandryshuar nga viti kaluar.**

**Humbje e mbartur ne shumen 30.329 leke e cila eshte zvogeluar sipas vendimit te ortakeve mbi miratimin e pasqyrave financiare 2018 ne shumen 341.376 leke.**

**Fitimi i mbartur i vitit 2018 ne shumen 6.202.622 leke eshte zvogeluar me humbjen e mbartur ne shumen 341.376 leke dhe diferenca eshte shperndare si dividend.**

**Fitimi i ushtrimit sipas bilancit kontabël paraqitet ne shumen 10.598.478 lekë.**

**Detyrimet**



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Ng Structures”shpk**

**(Per ushtrimin e myllur me date 31.12.2019)**

Detyrimet me vlerë 62.044.644 lekë përfaqësojnë:

	<i>Viti 2019</i>	<i>Viti 2018</i>
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	49.987.807	52.068.268
Te pagueshme ndaj punonjesve e sigurimeve shoqerore	7.279.323	1.321.312
Detyrime tatile	1.384.432	1.036.310
Te tjera detyrime	3.393.082	379.540
<b>Totali</b>	<b>62.044.644</b>	<b>54.805.430</b>

**Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit** per 49.987.807 leke paraqesin llogarine furnitore per vlerën e faturave të palikujduara.

**Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore** paraqitet detyrimi i shoqerise per paga ne shumen 6.403.038 leke dhe ndaj sigurimeve ne shumen 876.285 leke.

**Detyrimet tatile paraqesin:**

- Tatimi mbi pagën per 26.000 leke, detyrim per muajin nentor, dhjetor 2019.
- Tatim fitimi ne shumen 1.358.432 leke.

**Te tjera kerkesa** ne shumen 3.393.082 leke paraqet detyrim te shoqerise ndaj te treteve, si edhe detyrim te shoqerise ndaj ortakut.

### **Verifikimi i llogarise Fitime Humbje**

Shpenzimet dhe të ardhurat janë grupuar si më poshtë:

	<i>Viti 2019</i>	<i>Viti 2018</i>
<b>Te ardhura</b>		
Nga shitja e mallrave dhe sherbimeve	119.690.612	96.878.106
Te ardhura te tjera nga vepr. shfrytez		
Shtimi i gjendjes se produktit te gatshem		
<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>119.690.612</b>	<b>96.878.106</b>
Pakesim i gjendjes se produktit te gatshem		
Materiale te konsumuara	66.121.465	69.590.411
<b>Kosto e punës</b>		
Pagat e personelit	18.836.279	12.952.579
Shpenzimet per sigurime	16.108.729	11.113.481
Amortizimi dhe zhvleresimet	2.727.550	1.839.098
Shpenzime te tjera	305.900	
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>22.588.956</b>	<b>7.523.641</b>
Te ardhura te tjera	107.852.600	90.066.631
Diferencat nga kembimi	1.153.159	542.667
<b>Fitimi bruto</b>	<b>12.991.912</b>	<b>7.365.010</b>
<b>Tatim fitimi</b>	<b>2.393.434</b>	<b>1.162.388</b>
<b>Fitimi neto</b>	<b>10.598.478</b>	<b>6.202.622</b>



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Ng Structures”shpk**  
**(Per ushtrimin e myllur me date 31.12.2019)**

Shpenzimet jane 107.852.600 leke, ndersa te ardhurat 120.844.512 lekë. Rezultati neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj gjate ketij viti ushtrimor është fitim ne shumen 10.598.478 leke.

Te ardhurat e realizuara gjate ushtrimit perfaqesojne: te ardhura nga shitja e sherbimeve ne shumen 119.690.612 leke, te ardhura nga nxitja e punesimit ne shumen 1.153.159 leke dhe te ardhura nga kursi kembimit ne shumen 741 leke.

Shitjet jane rregistruar korrekt ne librat e shitjeve dhe te ardhurat rakordojne me situaten tatimore.

Shpenzimet per 107.852.600 lekë, jane te justifikuara me dokumenta te rregullta fiskale. Më konkretisht shpenzimet sipas zërave janë si më poshtë:

**Shpenzime per materiale ne shumen 66.121.465 lekë, ato janë përdorur për veprimtarinë kryesore të shoqërisë, këto shpenzime janë të justifikuara me dokumenta te rregullta tatimore.**

**Personeli, në këtë llogari janë pasqyruar shpenzimet për paga 16.108.729 lekë, sigurime shoqërore 2.727.550 lekë, listëpagesat janë përpiluar saktë dhe shpenzimet për paga e sigurime janë vendosur korrekt në këtë llogari. Nje permblehdhese e tyre paraqitet :**

	pb bruto	pg per kontribut	punedhenesi	punemarresi	sig shendetore	total sigurime	nr punetor	tapi	sig+tap
janar	1,438,239	1,682,909	213,114	134,625	49,599	397,338	66	24,626	421,964
shkurt	1,475,432	1,744,921	222,418	140,518	51,707	414,643	60	27,226	441,869
mars	1,402,154	1,671,644	211,428	133,558	49,216	394,202	57	27,226	421,428
prill	1,487,339	1,510,919	225,539	142,989	52,594	421,122	54	27,226	448,348
maj	1,183,613	1,226,068	183,091	115,958	42,387	341,436	46	14,226	355,662
qershor	1,159,248	1,219,431	182,915	115,847	41,463	340,225	46	14,226	354,451
korrik	1,177,153	1,177,153	176,572	111,829	40,024	328,425	45	14,876	343,301
gusht	1,117,149	1,117,150	167,572	106,129	37,984	311,685	44	10,976	322,661
shtator	1,175,057	1,175,057	176,258	111,630	39,952	327,840	45	10,976	338,816
tetor	1,447,086	1,447,086	217,062	137,473	49,201	403,736	52	13,000	416,736
nentor	1,558,169	1,629,081	244,362	154,763	55,389	454,514	59	13,000	467,514
dhjetor	1,488,090	1,511,727	226,759	143,614	51,398	421,771	56	13,000	434,771
	16,108,729	17,113,146	2,447,090	1,548,933	560,914	4,556,937	630	210,584	4,767,521

Amortizimi ne shumen 305.900 leke nuk kalon kufijte tatimor.

**Shpenzime te tjera per 22.588.956 leke paraqesin:**

- shpenzime per qera 343.750 leke,
- shpenzime udhetimi e djeta ne shumen 32.400 leke,
- shpenzime transporti ne shumen 18.393.589 leke,
- shpenzime komisioni banke ne shumen 28.258 leke,
- shpenzime per taksa ne shumen 155.630 leke,
- shpenzime per siguracione ne shumen 35.000 leke,
- shpenzime mirembajtje ne shumen 46.236 leke,



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Ng Structures”shpk**

**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)**

---

- shpenzime subvencion i ne shumen 200.000 leke,
- shpenzime gjoba ne shumen 2.964.313 leke,
- shpenzime te tjera ne shumen 389.780 leke.

Rezultati ushtrimor neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj është fitim 10.598.478 leke.

### **Çeshtje gjyqesore**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çeshtje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financier të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2019 Shoqeria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

### **Ngjarje pas datës së Bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi supozimin e biznesit në vijimësi, dhe drejtimi mendon se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

**Administrator**  
Hekuran Hoxha

*Hekuran Hoxha*